REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME

# Protokolli që duhet ndjekur nga udhëtaret që hyjnë në territorin e Shqipërisë

**2021-04-07 16:25:00**

Për të gjithë të interesuarit për të udhëtuar drejt Shqipërisë, njoftojmë se Shqipëria i ka hapur kufijtë ***në datën 1 qershor 2020.***

- **PËR TË GJITHË SHTETASIT QË KALOJNË NË TERRITORIN E SHQIPËRISË NË RRUGË TOKËSORE:**

? Nuk aplikohet detyrimi i karantinimit 14 ditor përvec rasteve të vecanta me urdhër të autoriteteve shëndetësore;
? Në pikat kufitare hyrëse nuk kërkohen dokumente specifike, për të hyrë në territorin shqiptar;
? Në pikat kufitare hyrëse do të matet vetëm temperatura e cila nuk duhet të kalojë 37.5 gradë. Në rast se kalohet kjo shifër, atëherë nuk do jetë i mundur vazhdimi i udhëtimit;
? Në rast hyrjeje në Shqipëri nga kufijtë tokësorë, duhet patur parasysh informimi mbi rregulloret e shteteve të tjera ku do kalohet gjatë udhëtimit, pasi ndryshojnë nga shteti në shtet.
? Shtetasit që udhëtojnë në rrugë tokësore për në Shqipëri duhet të marrin informacion paraprak në Ambasadat e shteteve përmes të cilave do të kryejnë tranzit, për të qenë të qartë mbi rregullat e vendosura nga këto shtete në kuadër të pandemisë.

- ***Individët që udhëtojnë në rrugë detare, duhet të komunikojnë me Përfaqësitë Shqiptare në vendet nga do nisen me mjete lundruese ose të kontaktojnë Ambasadat e këtyre vendeve.***
- ***Për udhëtarët që udhëtojnë nga vendet e trta me avion dhe përdorin si tranzit një nga Aeroportet Ndërkombëtare, të mbahet parasysh se:***

***Nuk do të lejohen të dalin nga zona e tranzitit të aeroportit dhe se nuk do të lejohen të vijojnë udhëtimin e tyre nëse destinacioni pasues është një vend tjetër i hapësirës Schengen, pasi kjo lëvizje nuk konsiderohet tranzit, por hyrje në hapësirën Schengen, prandaj autoritetet aeroportuale do t'i kthejnë në vendet nga kanë mbërritur.***

- ***Të gjithë udhëtarët të cilët lejohen të hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, përveç respektimit të protokollëve në standarde ndërkombëtare që vetë kompanitë ajrore aplikojnë kudo në botë, duhet të ndjekin dhe respektojnë rregullat e shënuara më poshtë:***
  ? Individët duhet të jenë të pajisur me maska për të hyrë në terminalin e Aeroportit Nënë Tereza;
  ? Fëmijët nën 6 vjeç dhe personat që për arsye shëndetësore nuk mund të mbajnë maskë përjashtohen nga ky rregull;
  ? Maskat duhet të ndërrohen çdo 4 orë, gjithashtu kur dëmtohen ose lagen pasi humbin efektshmërinë e tyre. Maskat mund të mbahen më shumë ose më pak nëse prodhuesi i maskave e ka specifikuar kohën e përdorimit të saj;

- Krahas maskës, zbatohen masat parandaluese të etikës respiratore, prekjes së fytyrës dhe higjienës së duarve.

? Nëse pasagjeri shfaq simptoma të COVID-19 të specifikuara më parë, ai/ajo nuk do të lejohen të vazhdojnë udhëtimin dhe të hyjë në Shqipëri;
? Duhen respektuar vendet e caktuara për hyrjen dhe daljen nga aeroporti;
? Aeroporti ka të vendosura pika të automatizuara për të pasur mundësinë

që udhëtarët të pajisen me maskë dhe dezinfektantë;
? Udhëtarët që hyjnë në terminal do të kalojnë në tunelin e dezinfektimit;
? Në momentin e check-in do të nënshkuhet një deklaratë mbi statusin e tyre në lidhje me COVID-19 përpara se të pajisen me boarding pass;
? Pasagjeri si në nisje dhe në mbërritje do t'i nënshtrohet matjes së temperaturës dhe nëse ajo i kalon 37.5 gradë, nuk do të jetë e mundur të vazhdohet me udhëtimin;
? Pasagjerët gjatë qëndrimit në aeroport duhet të respektojnë distancën sociale prej 1.5 metra nga njëri-tjetri gjatë gjithë kohës, sikurse gjatë dorëzimit të dokumentave ose bagazheve ruajtja e distancës nga sporteli, në dalje për tu nisur (gatet), në autobuzat e brendshëm të aeroportit, gjatë hypjes dhe zbritjes në avion si dhe ndërkohë të ndiqet sinjalistika e vendosur nga Autoritetet e Aeroportit, në tërësi.
? Prioritet kanë personat e moshuar, personat në nevojë dhe familjet me fëmijë të mitur;
? Inkurajohet kryerja e check-in online për të shmangur radhët dhe kontaktet fizike.
? Ata që nuk respektojnë rregullat dhe masat nuk do lejohen të futen në aeroport ose në rastin e nisjes nuk do lejohen të vazhdojnë me udhëtimin e tyre dhe do të shoqërohen nga autoritetet policore jashtë;
? Kërkohet që në rast se pasagjerët shfaqin simptoma, atëherë të mos ndërmarrin udhëtime por të zbatojnë rregullat e vendosura nga shtetet përkatëse.

❍ Mbani në vëmendjen tuaj, rregullat aktuale që janë në fuqi në Shqipëri:

- Kufizim i lëvizjes në të gjithë territorin e RSH-së, nga ora 22:00 deri në orën 06:00. Lejohet lëvizja vetëm për arsye shëndetësore ose emergjence. Përdorni aplikacionin E-Albania, për leje specifike.
- Baret, restorantet dhe klubet e natës janë të mbyllura nga ora 22:00 deri në orën 06:00, me përjashtim të shërbimit "delivery".
- Nuk lejohen grumbullimet mbi 10 persona, në ambjente të brendshme të jashtme.
- Maska është e detyrueshme në publik dhe në institucione, jo në bare/restorante.

❍ ***Kjo listë ndryshon vazhdimisht. Ju këshillojmë që të vizitoni faqen e Autoritetit të Aviacionit Civil [http://www.aac.gov.al/](http://www.aac.gov.al/) për informacion të përditësuar.***
❍ ***Për informacione të mëtejshme në lidhje me COVID-19 telefononi 127 dhe për këshillim psikologjik telefononi linjën e gjelbër 0800 40-40.***